

# PAKETË NDIHMËSE

PËR GAZETARËT  
QË SHKRUAJNË  
PËR TRAFIKIMIN E GRAVE  
DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI



Bashkimi Evropian



REPUBLICAN E SHQIPËRI  
MINISTRIA E PUNËVE  
TË BRENDSHME



United Nations Entity for Gender Equality  
and the Empowerment of Women

# PAKETË NDIHMËSE

PËR GAZETARËT  
QË SHKRUAJNË  
PËR TRAFIKIMIN E GRAVE  
DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI

2014



*Bashkimi Evropian*



Ky botim është realizuar në kuadër të projektit “EIDHR/2013/335-757: Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave e vajzave në Shqipëri”, i cili zbatohet nga UN Women Shqipëri dhe mbështetet financiarisht nga Komisioni Evropian.

Botimi përmban piktura të përgatitura nga vajza e gra të mbijetuara trafikimi. Të gjitha pikturat janë realizuar gjatë sesioneve të Terapisë së Artit, të cilat ofrohen rregullisht si pjesë e shërbimit psikologjik nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”.

## **UN WOMEN**

UN Women është organizata e Kombeve të Bashkuara kushtuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Përkrahëse botërore për gratë dhe vajzat, UN Women është themeluar për të përshpejtuar progresin dhe përmbushjen e të drejtave të grave në të gjithë botën.

UN Women vepron nën bindjen themelore se gratë dhe vajzat kudo në botë kanë të drejtën e një jete pa diskriminim, dhunë dhe varfëri dhe se barazia gjinore është në qendër të arritjes së zhvillimit.

Barazia gjinore nuk është vetëm një nga të drejtat themelore të njeriut, por duke fuqizuar gratë në vendet në zhvillim, nxit produktivitetin dhe sjell rritje ekonomike.

## **Ekipi i Autorëve:**

### **Studiuese Kryesore:**

**Dr. Bistra Netkova,**  
*Eksperte e të Drejtave të Njeriut dhe Trafikimit*

### **Ndihmuan në konceptim:**

**MA. Erisa Çela,**  
*Koordinatorë Kombëtare e Programit Fuqizimi Ekonomik i Gruas*

**MA. Vilma Çobani**  
*Koordinatorë në Njësinë Antitrafik, Ministria e Punëve të Brendshme*

**ISBN: 978-99956-51-88-6**

# Pasqyra e lëndës

<b>PJESA I</b>	5
1. Hyrje	6
2. Si mundet kjo paketë të shërbejë si një mjet ndihmës për gazetarët	7
3. Çfarë është trafikimi i qenieve njerëzore?	9
4. Kush mund të jetë viktimë?	10
5. Format e ndryshme të trafikimit	11
6. Vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit	12
7. Dallimi midis kalimit klandestin të migrantëve dhe trafikimit	14
<b>PJESA II</b>	17
1. Këshilla për pasqyrimin e historive të trafikimit duke filluar nga përgatitja deri tek shkrimi i tyre	18
2. Etika, konfidencialiteti, dinjiteti dhe vërtetësia	28
3. Ndiqeni ecurinë e historisë	29
4. Interesi komercial dhe ai publik, shitja e lajmit (lajmi “i rëndë” dhe lajmi “i lehtë”)	30
5. Mitet dhe konceptet e gabuara	32





# 1. HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore dëmton demokracinë dhe demokratizimin në shumë vende në zhvillim. Shifrat gjithnjë në rritje të trafikimit të qenieve njerëzore vijnë si rezultat i sipërmarrjeve të organizuara kriminale.

Aktivitete të tilla kriminale dhe korrupsioni zyrtar, i lidhur me trafikimin, i dobësojnë institucionet demokratike dhe vënë në pikëpyetje parimin e shtetit të së drejtës.

Roli që luajnë gazetarët në pasqyrimin e trafikimit të grave dhe vajzave është vendimtar. Përmes pasqyrimin të tij, gazetari ka mundësi ta bindë dhe/ose të ndikojë në opinionin publik dhe politikat e ndryshme, si edhe t'i analizojë ato nga këndvështrimi social. Nëse shkruhen me vërtetësi dhe saktësi, artikujt mund të shërbejnë si një katalizator për ndryshime pozitive në nivel lokal, kombëtar, por madje edhe ndërkombëtar, duke ndihmuar kështu në kalimin nga kultura e dhunës drejt një kulture pa dhunë gjinore.

## 2. SI MUNDET KJO PAKETË TË SHËRBEJË SI NJË MJET NDIHMËS PËR GAZETARËT

UN Women e pa të nevojshme të përgatiste një Paketë Ndhmëse për Median, e cila të adresonte çështje të përbashkëta të lidhura me mënyrën se si media i ndërton aktualisht lajmet rreth trafikimit të grave dhe vajzave dhe se si gazetarët mund t'i pasqyrojnë më mirë këto çështje. Më poshtë jepen disa nga pikat kryesore që tregojnë se përse kjo paketë konsiderohet e rëndësishme:

- Mungesa e kontekstit: Shumë lajme nxjerrin në pah aspekte provokuese ose bombastike të ngjarjeve;
- Mungesa e kontekstit të duhur dhe e informacionit statistikor që t'i përshtatet atij konteksti;
- Mungesa deri më tani e kërkimeve të

thelluara rreth lajmeve nga ana e medias, për të bërë krahasime të drejtpërdrejta midis ngjarjeve tronditëse që lidhen me një kontekst të caktuar, si për shembull me dhunën në familje.

- Përdorimi i kufizuar i një terminologjie të përbashkët për të rritur njohuritë rreth dhënies së lajmit, që lidhet me një informim më të thelluar të gazetarëve;
- Mbizotërimi i tendencës për të përfshirë një informacion dhe statistika me kontekst më të gjerë në një lajm që fokusohet te një histori e vetme.

Një nga rregullat e kodeve të etikës së gazetarisë, që citohet më shpesh, është ruajtja e paanshmërisë



në paraqitjen e një lajmi me shkrim ose me gojë. Megjithatë, ashtu sikurse e tregon edhe kjo paketë, ruajtja e një këndvështrimi të ekuilibruar mbetet një sfidë. Ndonëse të qenit të drejtë dhe të saktë janë aspekte etike, që gazetarët duhet t'i respektojnë, paanshmëria është një qëllim që nuk mund të arrihet asnjëherë plotësisht.

Sot, mënyra se si flitet dhe shkruhet për trafikimin ka më shumë rëndësi se kurrë. Duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën media sociale po zhvillohet dhe shpejtësinë në rritje me të cilën lajmet jepen, artikujt e gazetave nuk mbeten më në një faqe gazete që mund të bjerë në dorën e një audiencë të kufizuar dhe që pastaj ruhet diku. Lajmet e sotme janë dixhitale dhe, si rezultat, mund të jenë aty për t'i përdorur kushdo për të bërë kërkime online. Këto lajme mund të kenë një ndikim global të mirë ose të keq, në varësi të mënyrës se si i bëhen të ditura publikun. Ato shërbejnë si burime kërkimore dhe si dëshmi për hartimin e politikave publike. Ato mund të ndihmojnë në rrënjosjen e besimeve shoqërore dhe

stereotipive negative gjinore, të cilat nga ana e tyre do të vazhdojnë të thellojnë kulturën e përdhunimit në shoqëri. Për këtë arsye, rritja e ndërgjegjësimit të njerëzve rreth çështjes së trafikimit të grave dhe vajzave dhe kujdesi në pasqyrimin e tij, mund të ndihmojnë në dhënien e tablove më të gjera dhe më të vërteta të realitetit.

*Qëllimi i kësaj Pakete  
Ndhmëse për Median është të  
ndihmojë gazetarët në nivel  
vendor dhe kombëtar për t'i  
pasqyruar më mirë çështjet e  
trafikimit të grave dhe vajzave.*

### 3. ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE?

"Shkelja e të drejtave të njeriut përbën si shkakun, ashtu edhe pasojën e trafikimit të personave. Rrjedhimisht, është thelbësore që mbrojtja e të gjitha të drejtave të njeriut të vendoset në qendër të çdo mase të marrë për të parandaluar dhe për t'i dhënë fund trafikimit." (Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, nxjerrë nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut në Këshillin Ekonomik dhe Social (E/2002/68/Add.1), 20 maj 2002.)

*"Trafikim personash do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo pritja e personave përmes kërcënimit apo përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose pozitës së dobët, ose përmes dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka nën kontroll një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin të paktën shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punës apo shërbimeve të detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve."*  
**(Protokolli i Palermos 2001)**

#### 4. KUSH MUND TË JETË VIKTIMË?


# *Askush nuk shfrytëzohet me vullnetin e tij.*

Zakonisht trafikantët i rekrutojnë njerëzit përmes reklamave mashtruese, që u premtojnë atyre punë të ligjshme si punëtore shtëpie, kujdestare shtëpie, ose punë në industritë bujqësore. Viktimat e trafikimit të të gjitha llojeve vijnë nga zona rurale, periferike dhe urbane.


Sipërmarrjet tregtare që i mbajnë njerëzit kundër vullnetit të tyre dallohen nga disa shenja.

## 5. FORMAT E NDRYSHME TË TRAFIKIMIT

Viktimat e trafikimit për seks gjenden shpesh në rrugë ose duke punuar në ambiente që ofrojnë akte seksuale për fitim, p.sh. shtëpi publike, klube striptize, studio prodhimi materialesh pornografike. Këto lloj biznesesh mund të operojnë duke u maskuar si:



Njerëzit e detyruar të punojnë në kushte skllavërie mund të gjenden në:



## 6. VENDET E ORIGJINËS, TRANSITIT DHE DESTINACIONIT!

Trafikimi është një fenomen kompleks që shpesh udhëhiqet ose ndikohet nga faktorë socialë, ekonomikë, kulturorë dhe nga faktorë të tjerë.

Disa nga faktorët më të zakonshëm janë kushtet e vendit, të cilët i bëjnë njerëzit të duan të migrojnë në kërkim të kushteve më të mira: varfëria, shtypja, mungesa e të drejtave të njeriut, mungesa e mundësive sociale ose ekonomike, rreziqet për shkak të konflikteve, mungesa e stabilitetit, apo kushte të tjera të ngjashme. Mungesa e stabilitetit politik, militarizmi, trazirat civile, konfliktet e brendshme të armatosura dhe fatkeqësitë natyrore mund të çojnë në rritjen e trafikimit. Destabilizimi dhe zhvendosja e njerëzve i bën ata më të dobët ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit përmes trafikimit dhe punës së detyruar.


Këta faktorë tentojnë të ushtrojnë presion mbi viktimat, të cilat “detyrohen” të migrojnë e të bien nën kontrollin e trafikantëve, por ka edhe faktorë të tjerë të rëndësishëm që kanë tendencë të “tërheqin” viktimat të mundshme. Varfëria dhe pasuria janë koncepte relative, të cilat çojnë në modele migrimi dhe trafikimi, ku viktimat kalojnë nga kushtet e një varfërie të skajshme në kushtet e një varfërie më pak të skajshme. Në këto kushte, përhapja me shpejtësi e mediave transmetuese dhe e telekomunikimit, duke përfshirë edhe internetin, në të gjithë botën në zhvillim mund të ketë rritur dëshirën për të migruar në vendet e zhvilluara, por në të njëjtën kohë, mund t’i bëjnë edhe migrantët e ardhshëm më të dobët përballë trafikantëve.

Në trafikim ndikojnë edhe praktikat sociale dhe kulturore. Për shembull, zhvlerësimi i grave dhe

vajzave, dhuna na familje apo praktikat tradicionale të dëmshme në një shoqëri i bën ato edhe më të pambrojtura ndaj trafikimit, sesa do të ishin normalisht.

Mungesa e legjislacionit të duhur, si edhe e vullnetit dhe angazhimit politik, për të zbatuar legjislacionin ekzistues janë faktorë të tjerë që e lehtësojnë trafikimin e personave.

*“Rruga e Ballkanit është një prej rrugëve më të njohura të përdorura nga krimi i organizuar dhe nga trafikantët e qenieve njerëzore, ku viktimat shiten nëpër bodele dhe në tregje, për t’u kaluar në Shqipëri, e më pas drejt Sllovenisë, Hungarisë dhe BE-së”.*



## 7. DALLIMI MIDIS KALIMIT KLANDESTIN TË MIGRANTËVE DHE TRAFIKIMIT

Sipas Protokollit kundër Kalimit Klandestin të Migrantëve përmes Tokës, Detit dhe Ajrit, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional: (a) "Kalimi klandestin i migrantëve" do të thotë përfitimi, me qëllim marrjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një përfitimi financiar ose të një përfitimi tjetër material, nga hyrja e paligjshme e një personi në një Shtet Palë, ku ai nuk është shtetas apo banor i përhershëm; (Protokolli kundër Kalimit klandestin të Migrantëve përmes Tokës, Detit dhe Ajrit, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional)

'Komisioni është i mendimit se ndarja në një protokoll të Kombeve të Bashkuara për trafikimin e qenieve njerëzore dhe në një protokoll të Kombeve të Bashkuara për kalimin klandestin të migrantëve ka pasur qëllimin e vet. Ndërkohë që kalimi klandestin i migrantëve mund të thuhet se përbën krim kundër shtetit dhe që shpesh përfshin një interes reciprok mes trafikuesit dhe migrantit klandestin, trafikimi i qenieve njerëzore përbën krim kundër personit dhe përfshin qëllime shfrytëzuese.' Komisioni Evropian (COM 2000 854)









# 1. KËSHILLA PËR PASQYRIMIN E NGJARJEVE TË TRAFIKIMIT DUKE FILLUAR NGA PËRGATITJA DERI TEK SHKRIMI I TYRE

## PËRDORIMI I STATISTIKAVE

*Gazetarët duhet t'u referohen statistikave kombëtare dhe ndërkombëtare sa herë që është e mundur, për t'i vënë incidentet e veçanta në një kontekst më të gjerë social dhe për të dhënë “tablonë e plotë” në mënyrë që lexuesit, shikuesit dhe dëgjuesit të kenë mundësi ta kuptojnë ngjarjen. Përdorimi i shifrave për efektin tronditës të tyre, por duke pasur kujdes që të mos krijoni alarm, është me dobi për të vënë në dukje shkallën e përhapjes së praktikave të caktuara në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.*

## BURIMET

- Në fillim bëni një listë të burimeve dhe përpiquni të gjeni se kush tjetër ka informacion rreth subjektit të trafikimit të personave, në përgjithësi, dhe rreth rastit konkret në veçanti, me të cilët mund të flisni, kush mund të përbëjë një burim zyrtar, kë mund të përdorni si burim anonim dhe nëse keni realisht nevojë për një burim të tillë?

Është e rëndësishme që gjithmonë të keni një shpjegim të vlefshëm dhe të logjikshëm për përdorimin e një burimi të caktuar.

- Së dyti, kur përdorni një burim, mos harroni asnjëherë se ndoshta personi me të cilin po flisni, që po ju raporton apo informon

për diçka, mund të ketë qëllimin e vet dhe se mund t'ju përdorë për t'ia përçarur idetë dhe qëllimet e tij një audience shumë më të gjërë. Për këtë arsye, mos rrini në pritje që burimi tuaj t'ju tregojë “gjithçka”!

- Së treti, përpiquni të flisni me sa më shumë njerëz që të mundni, me njerëz që kanë informacione rreth ngjarjeve kriminale, që shoqërojnë trafikimin e personave, për të cilat ju interesoheni dhe përpiquni t'i konfirmoni rastet tuaja nga burime të ndryshme, nëse nuk mund t'i besoni plotësisht burimit kryesor që keni.
- Së katërti, asnjëherë mos përdorni vetëm një burim, përdorimi i më shumë burimeve i jep historisë thellësi dhe informacioni që i përçohet publikut do të ketë një ndikim më të madh social. Për shembull, artikulli i mëposhtëm është një artikull që përdor vetëm një burim, Policinë e Tiranës:

'Artur D., 38 vjeç, u arrestua dje në një apartament në Vorë nga specialistët e Njësisë së Luftës kundër Trafikimit, pasi ishte shpallur në kërkim nga autoritetet italiane. Sipas njoftimit të policisë së Tiranës, D. është dënua nga Gjykata e Milanos me shtatë vjet burg pas shpalljes fajtor për shfrytëzim femrash për prostitucion në rrethana të rënda, në bashkëpunim me persona të tjerë.'(artikull gazete).

- Përveç njoftimit për shtyp të autoriteteve, ka edhe burime të tjera, që duhet të shfrytëzohen për të marrë informacione më të mira rreth temës. Në fushën e trafikimit të grave dhe vajzave, organizatat joqeveritare, ashtu sikurse dhe institucionet ndërkombëtare që merren me këtë fenomen, apo që u ofrojnë ndihmë të drejtpërdrejtë viktimave mund të përbëjnë një burim të rëndësishëm të dhënash. Organizatat që shkruajnë zakonisht rreth trafikimit të personave janë: OSBE, UNODC, UN Women, IOM, Kwina till Kwina.

## PËRDORIMI I GJUHËS

E MBIJETUARA OSE VIKTIMA NUK KANË FAJ. Shumë artikuj i vënë theks më të madh se sa duhet mënyrës së sjelljes së një të mbijetuare ose viktime, duke lënë të kuptohet se e ka pasur vetë fajin që mbi të është ushtruar dhunë. Ajo çka kuptohet nga artikuj si ky është se në njëfarë mënyrë femrat me sjelljen e tyre e kanë kërkuar vetë dhunën e përjetuar.

### **MESHKUJT QË TRAFIKOJNË FEMRAT JANË PERSONAZHI I KEQ I LAJMIT.**

Ata nuk janë njerëz të zakonshëm; janë njerëz që janë sjellë në një mënyrë që konsiderohet e urryer prej nesh. Gazetarët që duan të zbulojnë të vërtetën dhe të shpjegojnë ngjarjet që ndodhin në botë, duhet ta fillojnë punën duke u nisur nga perceptime të sakta.

### **GRATË E TRAFIKUARA QË SHESIN SEKS NUK JANË TË PËRDALA APO PROSTITUTA.**

Ata janë gra që i kanë detyruar të prostitutojnë, të cilat janë gjithnjë nën kontrollin e një tutori ose/dhe të varura nga lëndët narkotike, përherë të pambrojtura, dhe që ndodhen

në skajet e shoqërisë. Etiketimi i tyre si të përdala apo prostituta nuk bën gjë tjetër, përveçse i portretizon ato në një mënyrë edhe më çnjerëzore. Ndërsa kur vriten, ato nuk janë “prostituta të vdekura” apo “prostituta të vrara”. Së pari, ato janë gra dhe vajza, së dyti janë viktime, kështu që, të shkruash rreth vdekjes së tyre duke theksuar më shumë mënyrën së si ato kanë jetuar, se sa praktikën e trafikimit që i shndërroi ato në viktime, do të thotë t’i fyesh përsëri, gjë që nuk do të konsiderohej me vend kur shkruani apo pasqyroni vdekjen e asnjë gruaje apo vajze tjetër.

Gazetarët duhet t’i zgjedhin me kujdes fjalët kur pasqyrojnë trafikimin e grave dhe vajzave dhe gjithmonë duhet t’i shmangin mënyrat e të shprehurit që lënë të kuptohet se fajin e ka viktime, t’i portretizojnë autorët si personazhe të këqij, ndërsa të mbijetuarat e dhunës, si gra reale. Gjithashtu, ata duhet të eksplorojnë faktorët që i kanë çuar ato në trafikim (varfëria, dhuna në familje, mungesa e perspektivës dhe papunësia).

**GRATË DHE VAJZAT NDAJ TË CILAVE ËSHTË USHTRUAR DHUNË, APO QË KANË QENË OBJEKT ABUZIMI GJATË KOHËS QË KANË QENË TË TRAFIKUARA MUND TË MOS DUAN QË TË ETIKETOHEN SI VIKTIMA, PASI KY ETIKETIM MUND T’U DUKET I DËMSHËM.**

që përshkruan me më shumë saktësi realitetin e një gruaje që ka vuajtur në këtë mënyrë është “e mbijetuara”. Në vend të këtij termi, mund të thoni thjesht “gratë që kanë qenë objekt abuzimi ose dhune” gjatë kohës që kanë qenë të trafikuar.

**KJO NUK ËSHTË “POLITIKISHT KORREKTE”.** Kjo do të thotë se duhen bërë realisht përpjekje për ta kuptuar problemin dhe për ta raportuar më saktësi në një mënyrë që t’i shërbejë debatit publik. Dhe ndoshta përdorimi i gjuhës dhe terminologjisë së ngjashme me atë të agjencive që i mbështesin dhe bëjnë fushata për gratë dhe vajzat që kanë qenë objekt trafikimi do ta përmirësonte shumë cilësinë e të shkruarit rreth kësaj çështjeje.

**HISTORIA E VËRTETË DHE RRËFIMET KONTRADIKTORE**

GAZETARËT DUHET TA TREGOJNË HISTORINË SIÇ ËSHTË, POR DUHET EDHE TË JENË TË KUJDESSHËM KUR ZGJEDHIN NJË RRËFIM DHE, NËSE ËSHTË E MUNDUR, DUHET TË BËJNË LIDHJET E SAKTA NË PASQYRIMIN E TIJ MIDIS FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE.

Në pjesën më të madhe të rasteve, trafikimi i grave dhe vajzave pasqyrohet në një mënyrë neutrale për sa i përket gjinisë, duke mos përmendur dimensionin gjinor të trafikimit. Sa herë që është e mundur, gazetarët duhet të jenë të hapur ndaj mundësisë që autorët e trafikimit mund të jenë të përfshirë në një sërë formash dhune ndaj grave, ose që faktorët që kanë çuar në këtë krim, mund të përbëjnë forma të tjera dhune ndaj grave.

SI DUHET TA HETONI NJË NGJARJE QË KA TË BËJË ME TRAFIKIM PERSINASH DHE SI TA PËRGATISNI PËR SHTYP DUKE BËRË NUMRIN MINIMAL TË GABIMEVE? CFARË DUHET DHE CFARË NUK DUHET TË BËNI!

DISA NGA GJËRAT QË DUHET TË BËNI:



1. Thoni të vërtetën.
2. Jeni të saktë dhe objektiv dhe, mbi të gjitha, të drejtë.
3. Përdorni teknika maskimi për të shmangur identifikimin e viktimës.
4. Shfaqni një lloj eupatie për viktimat. Përpquni të ndieni atë që ndiejnë ato.
5. Mos i ekspozoni, por ngrini zërin për kauzën e tyre.
6. Analizoni arsyet që qëndrojnë pas trafikimit.
7. Hetojni faktet. Ndhmoni në gjetjen e autorëve.
8. Vizitohini burimet e informacionit dhe realitetin merreni në gjithë kompleksitetin e tij.
9. Theksoni problemet me të cilat përballen të mbijetuarat, dhe jo traumën e tyre.
10. Raportoni për ato që ndodhin në gjykata – duke u fokusuar tek ligji, zbatimi i tij, vonesat, etj.
11. Zgjidhni fjalët me kujdes.

## DISA NGA GJËRAT QË NUK DUHET TË BËNI:



1. Kur dëshironi të përgatisni një shkrim të tillë, mos i trajtoni të mbijetuarat si objekte.
2. Përpiquni të mos i trajtoni si “viktima”.
3. Përpiquni të shmangni fotografimin e fytyrave të të mbijetuarave.
4. Përpiquni të mos u bëni viktimave pyetje që cenojnë dinjitetin e tyre. (Sa herë ju kanë përdhunuar? Sa klientë keni pasur në ditë?)
5. Përpiquni të mos i ktheni përsëri mendërisht në shtëpitë publike (duke u bërë një përmbledhje të rrugës që kanë përshkuar).
6. Përpiquni të mos bëheni personi që i merr viktimat në patronazh, apo të tregoni dhembshuri ose mëshirë për to.
7. Mos i shtrembëroni faktet me qëllimin për t’i bërë më sensacionale me foto, diçitura apo tituj me germa të mëdha.
8. Shmangni titujt sensacionalë të llojit të tabloidët.
9. Shmangini qëndrimet e llojit ato dhe ne
10. Jini objektiv. Nuk është nevoja që media të luajë rolin e gjykatësit



- Paraqitini në mënyrë të ekuilibruar të gjitha anët e ngjarjes.
- Përpiquni të jeni objektiv dhe neutral, por lini edhe hapësirë për të dalë në mbrojtje të tyre, që për mijëra njerëz do të përbënte ndryshimin midis jetës dhe vdekjes.
- Në lidhje me sa më sipër, mund t'i jepni më pak apo më shumë peshë njërës apo tjetrës palë dhe të shpjegoni se përse ju është dashur ta bëni këtë.
- Lini hapësirë edhe për historitë e riintegritimit të viktimave të trafikimit. Gjithashtu, nevojitet të fokusoheni në historitë pozitive të rehabilitimit dhe riatdhesimit të suksesshëm të viktimave. Trafikimi nuk është një histori pa fund. Jeta vazhdon edhe pas trafikimit.
- Fokusimi vetëm tek historitë e grave dhe vajzave të trafikuar përcion mesazhin e

gabuar se për to nuk ka më shpresë. Përpiquni sa të mundeni t'i fuqizoni personat që i kanë mbijetuar trafikimit në betejën e tyre për të vazhduar jetën.

### *Mos e ri-viktimizoni, por fuqizojeni viktimën*

Gazetarët duhet ta kenë të qartë se kur një lajm ka të bëjë me “prostituta”, në të vërtetë, ai ka të bëjë me shkeljen e të drejtave bazë të njeriut. Pavarësisht moshës, origjinës, arsimimit apo të shkuarës së tyre, këto gra janë para së gjithash viktima.

### *Mos shpërfillni kuptimin e vërtetë të mosrespektimit të viktimave (media vizuale)*

Kur raportoni drejtpërdrejtë në kohën që punoni me viktimat, duhet të tregoni kujdes maksimal për të mbrojtur identitetin e personave që vendosin të ngrenë zërin dhe të tregojnë historinë e tyre.

Çdo kontroll i befashëm në një shtëpi publike do të përbënte një lajm sensacional për çdo kanal televiziv.

Shpeshherë, gazetarët profesionistë të televizioneve kërkojnë që ta shoqërojnë policinë apo organizatat e shoqërisë civile gjatë kontrolleve të shpëtimit. Por, transmetimi direkt i këtyre ngjarjeve duhet të bëhet me kujdes. Transmetimi i planeve të marra nga afër të personave që shpëtohen do të shkelte të gjitha normat e raportimit etik.

Korrespondentët dhe kameramanët e tyre duhet të reagojnë me zhdërvjelltësi. Ndoshta është mirë që të planifikojnë paraprakisht teknikat dhe kërkesat e filmimeve që do të përdorin. Siluetat, profilet, filmimi kundër dritës, zbehja e dritës, përdorimi i filtrave, mosfilmimi i fytyrave – të gjitha këto mund të përbëjnë jo vetëm çështje stili, por edhe mënyra të kujdesshme të paraqitjes së një ngjarjeje të tillë.

## SI TË BËNI NJË INTERVISTË ME NJË VIKTIMË

### TEKNIKAT E MIRA TË INTERVISTIMIT

#### *Diskutojini dhe bini dakord për kushtet përpara intervistës*

Është e kuptueshme se shumë persona që i kanë mbijetuar trafikimit do të ngurronin të flisnin me hollësi me një të huaj për përvojat e tyre. Megjithatë, duke diskutuar me një person se deri ku ai është i gatshëm të flasë për një përvojë të tillë, mund të arrini një marrëveshje, nga e cila do të përfitonin të dyja palët. Kur bëhet fjalë për tema të vështira si abuzimi dhe dhuna, do të ishte me dobi të përcaktonit që në fillim fushat për të cilat dëshironi të diskutoni, në mënyrë që personi që do të intervistohet të përparitet për atë çka do të thotë dhe të mendojë se si do ta shprehë përvojën e tij .

Flisni që në fillim me redaktorin tuaj nëse mund t'i

ndryshoni emrat dhe disa nga detajet e ngjarjes, me qëllim për të mbrojtur anonimitetin e personave, dhe kini parasysh se shumë gra nuk duan që përbri artikujve të botohen edhe fotot e tyre. Në rastet kur ka edhe fëmijë të përfshirë në një histori, duhet të mbani parasysh edhe çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.

Nëse keni në plan të merrni me vete një fotograf ose kameraman, merrni masa që ta njoftoni personin që do të intervistoni në mënyrë që ai apo ajo të përgatitet dhe të ndihet sa më rehat që të jetë e mundur. Po kështu, mund edhe t'i sugjeroni personit që do të intervistoni se mund të marrin me vete dikë, si për shembull një punonjës që i ofron mbështetje e që mund ta ndihmojë të ndihet më rehat gjatë intervistës.

Informojeni gruan nëse dëshironi ta regjistroni intervistën dhe pyeteni nëse ajo pranon.

## *Gjetja e një vendi të përshtatshëm*

Kjo mund të varet shumë nga kërkesat e të intervistuarës, e cila mund të jetë e shqetësuar në lidhje me konfidencialitetin dhe për këtë arsye mund të mos jetë e gatshme që t'ju japë adresën e saj. Ju lutemi, mos harroni se strehëzat janë vende të sigurta, ku gratë mund të jetojnë pasi shpëtohen, kështu që ruajtja e fshehtësisë së këtyre vendeve është shumë e rëndësishme. Media e ka për detyrë që të shmangë ekspozimin e të intervistuarës ndaj abuzimeve të mëtejshme, duke përfshirë edhe shmangien e veprimeve që mund të dëmtojnë cilësinë e jetës së saj apo naminit e saj në komunitet. Prandaj, kur raportoni, bëni kujdes që të mos filmoni ambientet që mund të identifikohen nga audienca dhe mos bëni fotografi që mund të tregojnë vendin ku ndodhet viktimi.

## *Jeni të përgatitur që ta ndërprisni dhe ta filloni përsëri ose thjesht ta ndërprisni intervistën*

Në disa raste, ka gra që kur flasin për përvojat e tyre, ndihen të forta dhe në gjendje të ndihmojnë edhe të tjerat, duke gjetur kështu një qëllim për atë që bëjnë. Megjithatë, në disa raste të tjera, ka gra që ndonjëherë e kanë të vështirë, madje acarohen të flasin për atë që u ka ndodhur. Disa grave u duket sikur e jetojnë edhe një herë abuzimin. Të mbijetuarat kanë të drejtë të mos pranojnë t'i përgjigjen çfarëdolloj pyetjeje dhe të mos flasin për ato gjëra që nuk munden. Mund të ketë momente kur viktimat e trafikimit ka dëshirë të mos flasë për një kohë, ose thjesht do të mendojë për disa minuta se si të shprehet. Jepini viktimës kohën që i duhet dhe prisni derisa ajo t'i ketë gjetur fjalët e duhura. Gazetarët duhet që të gjitha kontaktet me të mbijetuarat e trafikimit t'i realizojnë duke respektuar përvojën, dinjitetin dhe sigurinë e tyre dhe në asnjë mënyrë të

mos e shtyjnë viktimën të thotë gjëra që në kushte të tjera nuk do t'i kishte thënë.

## *Kujdesuni që të mos jeni sipërfaqësorë*

Për shkak të natyrës së tyre, rastet e dhunës dhe abuzimit mund të jenë shumë të dëmshme dhe mund të jetë e vështirë të gjeni njerëz të gatshëm për të folur hapur rreth këtyre eksperiencave. Mund t'ju duhet të gjeni mënyra të tjera për ta paraqitur një ngjarje me vërtetësi dhe për t'i dhënë asaj një këndvështrim të ri – mund të përfshini persona aktivë në fushatat kundër dhunës, aktivistë të OJQ-ve, pjesë nga studime të rëndësishme apo imazhe të fuqishme.

## 2. ETIKA, KONFIDENCIALITETI, DINJITETI DHE VËRTETËSIA

*Trafikimi i personave është një fenomen kompleks dhe një praktikë e urryer. Kur punoni për një artikull rreth trafikimit të personave, çështjet më të mëdha të etikës së raportimit për ata që janë të pambrojtur, apo të dëmtuar nga trafikimi, dhe ata që i kanë mbijetuar trafikimit duhet të jenë në qendër të të gjitha hapave të ardhshme.*

Në realitete të tilla, përpiquni të fokusoheni jo vetëm tek vlera e historisë si lajm, por edhe te aspekti njerëzor i saj.

Të shkruash për të pasqyruar trafikimin e personave kërkon një nivel të lartë ndjeshmërie dhe mirëkuptimi nga ana e gazetarit. Ndonjëherë, dëshira për të folur rreth një ngjarjeje mund të ndikojë në jetën e subjekteve në mënyrë negative. Media ka po aq fuqi për ta dëmtuar një të mbijetuar sa edhe për ta

ndihmuar në rikthimin e saj në jetën e mëparshme.

Media e ka për detyrë të thotë të vërtetën. Por, po aq e rëndësishme është edhe sigurimi i autenticitetit të burimeve dhe informacioneve të marra. Të treguarit e një historie me të gjitha aspektet e saj sociale, emocionale, mjekësore, ligjore, dhe ekonomike në kontekstin e saj është edhe më e rëndësishme.

*Identitetet e të mbijetuarave dhe viktimave, madje edhe të familjarëve të tyre apo të atyre që punojnë me ta, nuk duhen bërë publike. Këshillohet që ata të informohen rreth pasojave që mund të ketë zbulimi i identitetit, edhe nëse ata bien dakord.*

### 3. NDIQENI ECURINË E NGJARJES



Gazetarët që shkruajnë rreth temave të rënda si trafikimi i femrave duhet që të përpiqen gjithmonë që të ndjekin ecurinë e ngjarjes fillestare, duke krijuar kështu një vazhdimësi të dramës njerëzore, mundësisht me fund pozitiv.

## 4. INTERESI KOMERCIAL DHE AI PUBLIK, SHITJA E LAJMIT (LAJMI “I RËNDË” DHE LAJMI “I LEHTË”)

### LAJMI “I RËNDË”

Gazetarët zakonisht preferojnë të shkruajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke i paraqitur faktet me një stil që zakonisht konsiderohet lajm i rëndë, i cili është i shpejtë dhe aktual. Për shkak të konkurrencës së madhe midis mediave – asaj elektronike dhe të shkruar, por edhe brenda secilës prej tyre – kjo kthehet zakonisht si në një garë midis shpejtësisë dhe vdekjes. Dihet se lajmet e rënda shiten më shumë. Ato janë në krye të lajmeve më të shitura. Por, shpesh ato detyrohen që të mos përfshijnë detaje dhe të mos marrin parasysh interesin njerëzor. Ky stil mund të përdoret për ta fokusuar vëmendjen drejtpërdrejt te realitetet e ashpra të trafikimit të femrave. Statistikat, studimet më të fundit dhe tendencat apo ditët me ngjarje të rëndësishme, mund të raportohen që të gjitha pikërisht në këtë

mënyrë të drejtpërdrejtë, me qëllim për të pasur një ndikim maksimal.

### LAJMI “I LEHTË”

Lajmet që kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave të njeriut të grupeve të caktuara shoqërore, si për shembull të femrave, është më mirë që bëhet një paraqitje “e lehtë” apo “e vonuar”, e ndodhisë.

Kur flitet apo shkruhet për histori të tilla si ato të trafikimit, shpesh koha nuk përbën një element të rëndësishëm dhe faktet bazë janë të njohura. Në një skenar të tillë, informacioni kryesor mund të ndërtohet pak nga pak, duke i paraprirë me një histori ilustruese, ndonjë të ashtuquajtur fakt, pak historik, një kontekst, një fushë të paqartë diskutimi

apo me një mënyrë të re të të parit të fakteve. Për ta bërë interesant një lajm të tillë “të lehtë”, gazetarit i duhet që historinë të paraqesë në mënyrë krijuese për të bindur redaktorin. Por, gazetari mund të provojë ta paraqesë historinë në thellësi (jo në mënyrë sipërfaqësore) dhe në mënyrë bindëse, duke gjetur informacione rreth ndonjë konvente globale të lidhur me temën, duke prezantuar ndonjë raport apo libër, etj. Koha në të cilën lajmi bëhet i njohur është thelbësore. Për shembull, lidheni lajmin me ndonjë ngjarje të ngjashme apo me ndonjë ditë të veçantë, për të folur për atë temë. Përdorini lajmet “e rënda” në kombinim me lajmet “e lehta”. Për shembull: Parlamenti miraton “Ligjin për parashikimin si vepër penale të përdorimit të shërbimeve seksuale të prostitutave” dhe përpikuni që çështjeve t’u futeni në thellësi, apo t’i kombinoni me prezantimin e aplikacioneve të lajmeve për të raportuar raste të viktimave të mundshme të trafikimit, apo me fushatën 16-ditore kundër dhunës ndaj grave, me javën kundër trafikimit, etj.

Një mënyrë tjetër për t’u dhënë vlerë lajmeve është që në to të përfshini studime, të dhëna apo zhvillime të reja në fushën përkatëse, ose thjesht të gjeni një këndvështrim të ri të të parit të tyre.

E njëjta qasje e drejtpërdrejtë mund të përdoret me sukses edhe kur shkruani apo flisni për veprime të tilla si kontrollet nëpër shtëpitë publike, operacionet e shpëtimit, etj. Sot, një gazetari e tillë parandaluese nga punonjësit e medias që shoqërojnë veprime të tilla e që qëndrojnë ndonjëherë në krye të fushatave të shpëtimit të punonjëseve të seksit, mund të shërbejnë për raportime shumë interesante dhe lajme televizive jashtëzakonisht të lakmuara.



## 5. MITET DHE KONCEPTET E GABUARA

### MITI

Miti 1: Persona të trafikuar mund të jenë vetëm të huajt ose emigrantët nga vende të tjera.

### REALITETI

Realiteti: Trafikimi i femrave brenda Shqipërisë nuk përfshin vetëm femrat e huaja. Ekziston edhe trafikimi i brendshëm.

### MITI

Miti 2: Trafikimi i qenieve njerëzore është në thelb një krim që duhet të përfshijë një formë udhëtimi, transporti, apo zhvendosjeje nga një kufi shtetëror në një tjetër ose kalimin e kufijve.

### REALITETI

Realiteti: Trafikimi nuk përfshin patjetër transportin. Ndonëse transporti mund të përfshihet si një mekanizëm kontrolli për t'i mbajtur viktimat në ambiente që ato nuk i njohin, ai nuk përbën një element të domosdoshëm të përkufizimit të trafikimit. Trafikimi i personave nuk është sinonim i migrimit apo kalimit klandestin të detyruar, që përfshin kalimin e kufirit.

### MITI

Miti 3: Trafikimi i personave është një tjetër term për kalimin klandestin të njerëzve.

## REALITETI

Realiteti: Kalimi klandestin është një krim ndaj kufijve të një vendi: trafikimi i personave është një krim kundër personit. Secili prej tyre përbën një krim federal më vete në Shtetet e Bashkuara. Ndërkohë që kalimi klandestin përfshin kalimin e paligjshëm të kufirit, trafikimi i njerëzve përfshin akte seksuale ose punë dhe shërbime fitimprurëse, që sigurohen përmes përdorimit të forcës, mashtrimit ose shtërngimit, pavarësisht nëse përfshijnë apo jo transportin.

## MITI

Miti 4: Për identifikimin e një situatë të trafikimit të qenieve njerëzore, duhet të ketë elemente të shtërngimit fizik, forcës fizike, ose lidhjes fizike.

## REALITETI

Realiteti: Nuk është e thënë që trafikimi të përfshijë

shtërngime fizike, dëmtime trupore, apo forcë fizike. Mënyrat psikologjike të kontrollit si kërcënimet, mashtrimet, apo abuzimet me proceset ligjore, përbëjnë elemente të mjaftueshme të krimit.

## MITI

Miti 5: Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore menjëherë do të kërkojnë ndihmë dhe do të vetë-identifikohen si viktima të krimit.

## REALITETI

Realiteti: Shpesh, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore nuk kërkojnë menjëherë ndihmë dhe nuk e identifikojnë veten si viktima të një krimi për shkak të një sërë faktorësh, duke përfshirë mungesën e besimit, fajësimin e vetes, apo për shkak të udhëzimeve të posaçme që kanë marrë nga trafikantët në lidhje me mënyrën se si duhet të sillen kur flasin me zbatuesit e ligjit apo shërbimet sociale.

Është e rëndësishme që të mos arrihet në gjykime të nxituara se kush është dhe kush nuk është viktimë r trafikimit menjëherë pas takimit të parë.

## MITI

Miti 6: Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore vijnë gjithmonë nga situata varfërie ose nga fshatra të vegjël.

## REALITETI

Realiteti: Ndonëse varfëria mund të jetë një faktor në trafikimin e qenieve njerëzore, pasi shpesh ajo përbën një tregues dobësie, varfëria në vetvete nuk mund të jetë një faktor që çon patjetër në trafikim dhe nuk mund të jetë një tregues universal i një viktimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Viktimat e trafikimit mund të vijnë nga një gamë me nivele të ndryshme të ardhurash dhe shumë mund të vijnë edhe nga familje me status të lartë social-ekonomik.

## MITI

Miti 7: Trafikimi për seks është forma e vetme e trafikimit të qenieve njerëzore.

## REALITETI

Realiteti: Përkufizimi ndërkombëtar i trafikimit të qenieve njerëzore përfshin si trafikimin për qëllime seksuale ashtu edhe trafikimin për qëllime pune dhe ky krim mund të prekë si meshkujt, ashtu edhe femrat, si fëmijët, ashtu edhe të rriturit.

## MITI

Miti 8: Trafikimi i qenieve njerëzore ndodh vetëm në industri të paligjshme dhe të fshehta.

## REALITETI

Realiteti: Trafikimi mund të ndodhë si në biznese të ligjshme, ashtu edhe në tregje të fshehta. Trafikimi i

qenieve njerëzore është raportuar në tregje biznesi si restorante, hotele, dhe fabrika prodhuese, por edhe në tregje të fshehta, si seksi fitimprurës nëpër shtëpi publike rezidenciale dhe seksi fitimprurës në rrugë.

### MITI

Miti 9: Kur personi i trafikuar ka qenë dakord me situatën e tij fillestare, ka qenë i informuar paraprakisht mbi llojin e punës që do të bënte, apo që kjo punë do të përfshinte edhe seks për qëllime fitimi, atëherë nuk kemi të bëjmë me trafikim të qenieve njerëzore apo me trafikim kundër vullnetit të tij, sepse personi “e ka ditur që në fillim”.

### REALITETI

Realiteti: Të qenit fillimisht dakord me seksin për qëllime fitimi apo punën për qëllime fitimi përpara ushtrimit të akteve të forcës, mashtrimit, apo shtrëngimit (apo në qoftë se viktima është e mitur në një situatë trafikimi për shfrytëzim seksual), nuk

ka rëndësi për krimin, ashtu sikurse nuk ka rëndësi edhe nëse viktima është paguar.

### MITI

Miti 10: Viktimat e huaja të trafikimit janë gjithmonë emigrante pa dokumente ose që kanë hyrë në këtë vend në mënyrë të paligjshme.

### REALITETI

Realiteti: Jo të gjitha viktimat e huaja të trafikimit janë pa dokumente. Personat e huaj të trafikuar mund të vijnë në Shqipëri në mënyra të ligjshme dhe të paligjshme. Ndonëse disa nga viktimat e huaja të trafikimit janë pa dokumente, një përqindje e konsiderueshme ka viza të rregullta për qëllime të ndryshme.



ISBN 978-99956-51-88-6



9 789995 651886

barrett  
nainnesse